



ANALIZA E DYTË GJASHTËMUJORE E RASTEVE TË INDEKSIT TË INTEGRITETIT POLITIK

-Kur mekanizmat e kontrollit dështojnë-

Shkup, Qershor 2026

Përmbledhje ekzekutive

Forca e institucioneve demokratike nuk buron vetëm nga ligjet dhe kompetencat që ato kanë, por edhe nga besimi që qytetarët kanë në to. Kur qytetarët besojnë se institucionet punojnë me ndershmëri, paanshmëri dhe në suaza të interesit publik, ata i pranojnë më lehtë vendimet e tyre, i respektojnë rregullat dhe marrin pjesë më aktivisht në proceset demokratike. Por kur integriteti i institucioneve vihet në dyshim, besimi fillon të bjerë gradualisht, dhe bashkë me të ulet edhe legjitimiteti i veprimit institucional.

Gjashtë rastet e analizuara në këtë cikël gjashtëmujor të Indeksit të Integritetit Politik¹ tregojnë një vazhdimësi shqetësuese të cenimit të integritetit në disa segmente të sektorit publik. Edhe pse rastet përfshijnë institucione dhe fusha të ndryshme, si vetëqeverisja lokale, mekanizmat për antikorrupsion, shëndetësinë dhe sektorin e sigurisë, analiza e tyre zbulon një karakteristikë të përbashkët: dobësi në mekanizmat e parandalimit, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies që duhet të garantojnë mbrojtjen e interesit publik. Më e rëndësishmja, ato tregojnë një kulturë të gjatë mosndëshkueshmërie, e cila krijon hapësirë që abuzimet dhe shkeljet e integritetit të përsëriten më lehtë.

Gjatë periudhës së analizuar u evidentuan raste të dyshimeve për keqpërdorim të detyrës zyrtare, konflikte interesi, menaxhim jotransparent, veprim të paligjshëm nga ana e zyrtarëve, si dhe aktivitete që rrezikojnë drejtpërdrejt shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve. Disa prej rasteve përfunduan me dorëheqje, kallëzime penale ose procedura institucionale, ndërsa të tjerat hapën pyetje serioze për efikasitetin e mekanizmave ekzistues të kontrollit.

Gjetja më e rëndësishme e këtij cikli është se, në pjesën më të madhe të rasteve të analizuara, reagimi institucional vjen vetëm pasi problemet bëhen objekt i interesit publik, hetimeve mediatike ose veprimit të organeve të tjera kompetente. Në vend që të veprojnë në mënyrë parandaluese, institucionet shpesh reagojnë pasi dëmi veçmë është bërë dhe pasojat janë të dukshme. Edhe pse rastet ndryshojnë për nga peshat dhe rrethanat, të gjitha tregojnë të njejtën sfidë: sisteme jo mjaftueshëm efikase të kontrollit të brendshëm, verifikimit dhe përgjegjësisë. Kur problemet zbulohen më shpesh përmes presionit publik dhe jo përmes mekanizmave institucionale, krijohet përshtypja se sistemi reagon ndaj krizave, në vend që t'i parandalojë ato.

Në këtë drejtim, raporti rekomandon vendosjen dhe zbatimin e qëndrueshëm të sistemeve për menaxhimin e integritetit, kontrole të rregullta të rreziqeve nga konflikti i interesit dhe keqpërdorimi i funksionit, forcimin e mbrojtjes së sinjalizuesve, transparencë më të madhe në procedurat disiplinore dhe mbikëqyrëse, si dhe vendosjen e standardeve të qarta për llogaridhënien e strukturave drejtuese. Në afat të gjatë, integriteti nuk duhet parë si detyrim administrativ ose formal, por si parakusht thelbësor për institucione demokratike funksionale. Besimi i qytetarëve nuk krijohet përmes deklaratave, por përmes shembujve të përditshëm të përgjegjësisë, transparencës dhe respektimit të interesit publik. Sa

¹ <https://shorturl.at/KO8xS>

më shumë që institucionet tregojnë kapacitet për t'i njohur dhe korrigjuar dobësitë e tyre, aq më i madh do të jetë besimi se ato vërtet punojnë në shërbim të qytetarëve.

I - HYRJE

Gjashtë rastet e analizuara në këtë periudhë gjashtëmujore të Indeksit të Integritetit Politik vijnë nga institucione dhe sektorë të ndryshëm, si vetëqeverisja lokale, institucionet për antikorrupsion, shëndetësia dhe sektori i sigurisë. Në shikim të parë, ato duken si ngjarje të izoluara me rrethana dhe aktorë të ndryshëm. Megjithatë, analizimi më i thelluar tregon se të gjitha kanë një karakteristikë të përbashkët: mekanizmat institucionalë që duhej të parandalonin, zbulonin ose sanksiononin në kohë rreziqet për integritetin nuk kanë funksionuar në mënyrë efikase.

Në rastet e analizuara vërehen forma të ndryshme të cenimit të integritetit, nga dyshime për keqpërdorim të pozitës zyrtare, konflikte interesi dhe mungesë transparence në emërime, deri në veprime të paligjshme nga mbajtës të autorizimeve publike, mangësi në kontrollin e personelit dhe dobësi në mbikëqyrjen institucionale. Edhe pse pesha dhe natyra e këtyre rasteve ndryshojnë, emëruesi i përbashkët është mungesa e sistemeve efektive të parandalimit dhe paralajmërimit të hershëm që do të shmangnin shndërrimin e problemeve në skandale publike ose procese penale.

Veçanërisht shqetësues është fakti që në pjesën më të madhe të rasteve reagimi institucional vjen vetëm pasi problemi veçmë është bërë objekt i interesit publik, hetimeve mediatike ose veprimit të organeve të tjera kompetente. Në vend që mekanizmat e kontrollit të brendshëm të jenë linja e parë e mbrojtjes së integritetit, ato shpesh shfaqen si reagim i fundit pas dëmit të shkaktuar. Kjo krijon perceptimin se sistemi reagon ndaj krizave, në vend që t'i parandalojë ose t'i zbulojë me kohë.

Rastet e përfshira në këtë raport gjithashtu tregojnë se cenimi i integritetit nuk është vetëm problem individual i disa funksionarëve apo zyrtarëve. Kur mangësitë përsëriten në institucione dhe sektorë të ndryshëm, ato fillojnë të tregojnë për dobësi më të gjera sistematike në kulturën e llogaridhënies, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe zbatimin e parimit të përgjegjësisë. Në këto rrethana, çdo rast i ri ka efekt kumulativ mbi besimin publik dhe e forcon më tej perceptimin se rregullat nuk vlejnë njësoj për të gjithë.

Përvoja e shumë demokracive tregon se besimi në institucione nuk humbet përmes një skandali të vetëm, por përmes akumulimit të rasteve në të cilat qytetarët shohin se sistemi nuk arrin të mbrojë me kohë interesin publik, mjetet publike ose sundimin e ligjit. Pikërisht për këtë arsye, çështja e integritetit nuk është vetëm çështje e përgjegjësisë individuale, por edhe e kapacitetit institucional për vetëkontroll, llogaridhënie dhe korrigjim të dobësive të veta.

II - Raste individuale

II.1 Rasti – Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit



Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) është një shtyllë kyçe institucionale në sistemin e parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Si organ me mandat ligjor për mbikëqyrjen e funksionarëve publik dhe transparencën e veprimtarisë së tyre, integriteti dhe paanshmëria e vetë KSHPK-së janë parakusht për besimin e qytetarëve dhe për funksionimin e sundimit të ligjit.

Brenda një periudhe të shkurtër prej vetëm 6 muajsh, në opinion janë shfaqur kontestime serioze lidhur me punën e KSHPK-së dhe anëtarëve të saj, të cilat kulmuan me dy dorëheqje: të kryetares [Tatjana Dimitrovska](#), pas ngritjes së aktakuzave nga Prokuroria, dhe të anëtares [Cveta Ristovska](#), pas javësh dyshimesh publike për konflikt të mundshëm interesi dhe mosrespektim të detyrimeve për deklarimin e

pasurisë.

Vlerësimi i integritetit politik: kategoria “VULË E ZEZË” me vlerë negative –10

Sipas indikatorëve të metodologjisë, në këtë rast ekzistojnë disa elemente që tregojnë për një cenim serioz të integritetit të institucionit: erozion i thellë i besimit, ekspozim i plotë publik, pasoja serioze, dorëheqje morale dhe dëmtim i interesit publik.

Kategori: Mbrojtja e interesit publik

Argumentet kryesore:

1. Dorëheqja e kryetares së KSHPK-së, Tatjana Dimitrovska

Kryetarja e Komisionit dha dorëheqje pasi [Prokuroria për Ndjekjen e Krimit të Organizuar ngriti aktakuzë](#) kundër saj për dy vepra penale – zbulim të sekretit zyrtar dhe falsifikim kompjuterik. Kjo aktakuzë shkaktoi polemika publike mbi aftësinë e Komisionit për të vazhduar marrjen e vendimeve pa dyshime për ligjshmërinë, legjitimitetin dhe transparencën e veprimtarisë së tij.

2. Dorëheqja e anëtares Cveta Ristovska

Pas javësh dyshimesh dhe debatesh publike lidhur me veprimtarinë e saj, Ristovska dha dorëheqje të parevokueshme nga funksioni si anëtare e KSHPK-së, pasi vetë [Komisioni kishte hapur raste për dyshimet e ngritura](#). Këto raste lidhen me konflikt interesi dhe mosdeklarim të pasurisë/bizneseve – konkretisht, një kompani në pronësi të njërit prej bijëve të saj që kishte përfituar mjete nga fushatat e partive për reklamim zgjedhor, si dhe mosdeklarimi i bizneseve në fletën e deklarimit.

3. Indikatorë të shumtë për dobësi në integritetin e KSHPK-së

Të dyja dorëheqjet janë rezultat i presionit publik të jashtëm, si pasojë e dobësive të brendshme institucionale, duke treguar për një funksionim të dëmtuar të organit që duhet të garantojë paanshmërinë ndaj bartësve të funksioneve publike. Reagimet dhe kritikrat publike tregojnë për një perceptim se KSHPK mund të favorizojë subjekte të caktuara ose të mos reagojë në mënyrë efektive në verifikimin e anëtarëve të vet, gjë që cenon kredibilitetin e institucionit.

Rekomandime për mbrojtjen e integritetit:

Për të rikthyer besimin në KSHPK dhe për të forcuar integritetin e saj:

1. Të hapet një debat publik për ndryshimin e procedurës së përzgjedhjes dhe verifikimit të anëtarëve të Komisionit, duke forcuar transparencën dhe kushtet e përzgjedhjes, me fokus të veçantë në shmangien e konfliktit të interesit.

2. Të vendosen mekanizma të qartë kontrolli për anëtarët e KSHPK-së dhe për të punësuarit e saj, përfshirë forcimin e procedurave për verifikimin e deklaramit të plotë të pasurisë dhe interesave afariste të anëtarëve dhe familjarëve të tyre.
3. Të futen mekanizma ligjorë shtesë për pezullimin ose hetimin e anëtarëve të KSHPK-së menjëherë pas paraqitjes së dyshimeve për shkelje të detyrimeve ligjore.
4. Të plotësohet Kodi Etik i KSHPK-së me një dispozitë që kërkon transparencë të shtuar për hetimet dhe rastet që lidhen me anëtarët e saj, duke përfshirë publikimin e rezultateve brenda 24 orëve nga përfundimi i tyre.
5. Të ndiqet [Koncepti i Integritetit](#) i publikuar në faqen zyrtare të Komisionit dhe të parashikohet matje e rregullt e opinionit publik për punën e tij, si dhe aktivitete të tjera që krijojnë një sistem kontrolli dhe bilanci për rikthimin e besimit të qytetarëve.

Institucionet që kanë për detyrë të mbrojnë sundimin e ligjit dhe që kanë mandat ligjor për mbikëqyrjen e funksionarëve public dhe partive politike, veçanërisht në fushën e konfliktit të interesit, duhet të jenë shembull dhe t'i zbatojnë këto parime para së gjithash ndaj vetë anëtarëve të vet. Ato duhet të jenë plotësisht transparente, të paanshme dhe të përgjegjshme përpara mekanizmave të qartë të llogaridhënies. Dorëheqjet e Tatjana Dimitrovska dhe Cveta Ristovska, si rezultat i akuzave, dyshimeve dhe presionit publik, tregojnë për sfida serioze në integritetin e KSHPK-së dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në besimin e publikut në proceset e parandalimit të korrupsionit.

II.2 Rasti – Emërimet në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse nga këshillat e komunave pa transparencë



Në fokus të kësaj analize është veprimi i këshillave të vetëqeverisjes lokale, përfshirë edhe Këshillin e Qytetit të Shkupit, në procesin e emërimit të anëtarëve në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse të institucioneve publike (çerdhe, shkolla dhe ndërmarrje publike).

Bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shërbimeve kyçe publike, gjë që e rrit rëndësinë e këtyre vendimeve. Duke qenë se emërimet miratohen nga këshilltarët e zgjedhur, ekziston përgjegjësi e drejtpërdrejtë politike, ndërsa ndikimi mbi interesin publik është i konsiderueshëm.

Sipas informacioneve publike dhe raportimeve mediatike, këto emërimë kryhen pa publikimin e biografive dhe pa një procedurë transparente.

Kategori: transparencë, llogaridhënie

Vlerësimi i integritetit politik: –1 “HIJE”

Disa raportime mediatike tregojnë për një praktikë të përsëritur të emërimeve jotransparente, pa informacione bazë për personat e përzgjedhur dhe pa argumentim të qartë për kompetencën e tyre. Kjo tregon për dobësi në zbatimin e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e institucioneve publike.

Sipas metodologjisë së Indeksit të Integritetit Politik, ky rast i përket kategorisë “Hije” me vlerë –1.

Argumentet kryesore

Argumentet bazohen në informacione publike dhe raportime mediatike:

- Këshilli i Qytetit të Shkupit ka emëruar [117 anëtarë në bordet drejtuese](#), ndërsa për një pjesë të tyre [nuk janë dorëzuar biografi](#) te këshilltarët, duke kufizuar transparencën mbi kualifikimet dhe përshtatshmërinë e tyre për funksionin.
- Gjithashtu, në bordet drejtuese të çerdheve dhe shkollave të mesme janë emëruar [88 persona pa informacione publike për përvojën e tyre profesionale](#).
- Kjo praktikë krijon rrezik për emërimë të bazuara në përkatësi politike ose klientelizëm.
- Praktika të ngjashme vërehen edhe në [komuna të tjera](#), duke sugjeruar një model më të gjerë dhe potencialisht sistemik.
- Mungesa e transparencës kufizon kontrollin publik dhe llogaridhënien, duke ndikuar drejtpërdrejt në besimin e qytetarëve dhe duke ulur integritetin e institucioneve.

Rekomandime:

Për të mbrojtur integritetin e institucioneve dhe për të parandaluar cenimin e mëtejshëm të besimit publik, rekomandohet:

- Vendosja e procedurave të qarta për përzgjedhjen e anëtarëve në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse.
- Detyrimi për publikimin në kohë të biografive dhe kualifikimeve të të gjithë kandidatëve të propozuar para emërimit të tyre.
- Sigurimi i një debati transparent dhe thelbësor në këshilla përpara marrjes së vendimeve.

- Zgjerimi i [praktikave pozitive të vendosura në Qytetin e Shkupit lidhur me uljen e kompensimeve dhe numrit të anëtarëve në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse](#), si dhe plotësimi i tyre me rregulla të qarta për cilësi dhe transparencë përmes vendosjes së standardeve të përbashkëta në nivel të BNJVL (ZELS).

Përfundim

Emërimet në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse pa kriteret e qarta dhe pa transparencë mbi kualifikimet e kandidatëve e dobësojnë sistemin e qeverisjes së mirë. Këto praktika jo vetëm që kufizojnë mbikëqyrjen publike, por krijojnë edhe perceptim për politizim dhe klientelizëm, duke dëmtuar integritetin e institucioneve dhe besimin e qytetarëve. Në kuadër të Indeksit të Integritetit Politik, ky rast përfaqëson një “Hije” – një sinjal për nevojë për përmirësime sistematike.

II.3 Rasti – Keqpërdorimi i pushimeve mjekësore te nëpunësit publikë



Në fokus të kësaj analize është keqpërdorimi i së drejtës për pushim mjekësor nga ana e të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), si dhe reagimi institucional ndaj këtyre rasteve. Analiza bazohet në [informacione të disponueshme publikisht dhe raportime mediatike për kontrollin e realizuar nga Fondi për Sigurim Shëndetësor \(FSSH\)](#), gjatë të cilit janë konstatuar parregullsi, keqpërdorime sistematike dhe modele të përsëritura të abuzimit me dhënien dhe shfrytëzimin e pushimeve mjekësore te zyrtarët policorë.

Rasti hap çështje lidhur me kulturën e integritetit brenda MPB-së, efektivitetin e mekanizmave të kontrollit, respektimin e procedurave ligjore, si dhe përgjegjësinë individuale të të punësuarve për sjelljen e tyre.

Kategori: Korrupsion

Vlerësim: NJOLLË (-6)

Sipas metodologjisë, rasti vlerësohet si **“Njollë” me vlerë –6**, duke pasur parasysh ekzistencën e keqpërdorimeve të dokumentuara dhe të përsëritura të së drejtës për pushim mjekësor.

Vlerësimi i referohet njëkohësisht kontekstit institucional që mundëson praktika të tilla, por edhe sjelljes individuale të zyrtarëve që me vetëdije e keqpërdorin sistemin. Këto veprime përbëjnë cenim të drejtpërdrejtë të interesit publik dhe të parimeve themelore të integritetit, veçanërisht duke pasur parasysh se bëhet fjalë për nëpunës publikë në një sektor me përgjegjësi të lartë.

Argumentet kryesore

Bëhet fjalë për një institucion me nivel të lartë përgjegjësie publike (sektori i sigurisë), ku keqpërdorimi i pushimeve mjekësore ndikon drejtpërdrejt në aftësinë operationale të policisë. Rastet e shumta dhe të përsëritura tregojnë jo vetëm për dobësi sistematike, por edhe për mungesë përgjegjësie personale te një pjesë e të punësuarve, të cilët me vetëdije e keqpërdorin sistemin. Një sjellje e tillë minon drejtpërdrejt besimin e qytetarëve dhe cenon integritetin e institucionit.

- Sipas kontrollit të Fondit për Sigurim Shëndetësor, te të punësuarit në MPB janë konstatuar keqpërdorime të konsiderueshme të pushimeve mjekësore; nga 514 raste të kontrolluara, rreth një në pesë pushime mjekësore ka qenë i parregullt. Në kontroll janë përfshirë 80 zyrtarë policorë, prej të cilëve te 29 janë konstatuar parregullsi, që përbën një përqindje të lartë rastesh problematike.
- Janë identifikuar modele konkrete abuzimi, përfshirë ndërrimin e shpeshtë të mjekëve amë për të zgjatur pushimin mjekësor, si dhe hapjen e pushimeve të reja me diagnoza të ndryshme, çka tregon për ekzistencën e një sistemi të sofistikuar keqpërdorimi.

- Për parregullsitë e konstatuara janë shqiptuar gjoba në vlerë totale rreth 1.2 milionë denarë, duke treguar për dëm material dhe keqpërdorim të mjeteve publike.
- Keqpërdorimi i pushimit mjekësor nuk përbën thjesht parregullsi administrative, por një zgjedhje të vetëdijshme që minon besimin në shërbimin publik.

Rekomandime për mbrojtjen e integritetit

Rasti tregon jo vetëm dobësi sistemike, por edhe cenim serioz të integritetit individual të një pjesë e të punësuarve. Edhe pse ekziston një reagim fillestar institucional përmes kontrolleve dhe gjobave, përmasat e parregullsive tregojnë nevojën për masa më të thella strukturore. Keqpërdorimi i së drejtës për pushim mjekësor, sidomos në sektorin e sigurisë, përbën sjellje të vetëdijshme që dëmton drejtpërdrejt funksionimin e institucionit dhe besimin e qytetarëve. Prandaj, përgjigjja nuk duhet të kufizohet vetëm në përmirësime sistemike, por duhet të përfshijë edhe përgjegjësi të qartë dhe të dukshme individuale.

- Ministria e Punëve të Brendshme të vendosë mekanizma të përforcuar të kontrollit të brendshëm për monitorimin e pushimeve mjekësore.
- Të krijohet një sistem për zbulimin e hershëm të modeleve të dyshimta (pushime të shpeshta, ndërrim i mjekëve amë, diagnoza të përsëritura).
- Të forcohet koordinimi me Fondin për Sigurim Shëndetësor dhe institucionet shëndetësore për parandalimin e abuzimeve.
- Të sigurohet transparencë në trajtimin e rasteve të konstatuara, me qëllim rikthimin e besimit në institucion.
- Të vendoset praktikë e përgjegjësisë së qartë individuale, për të dërguar një mesazh të qartë se sjellje të tilla janë të papranueshme.

II.4 Rasti – Aksioni “Botoks”: tregti e paligjshme me preparate mjekësore të falsifikuara dhe rrezikim i shëndetit publik

ИНДЕКС НА ПОЛИТИЧКИ ИНТЕГРИТЕТ

СЛУЧАЈ #10

Акција *Ботокс*: нелегална трговија со фалсификувани медицински препарати и загрозување на јавното здравје



Категорија: заштита на јавниот интерес



Në fokus të kësaj analize është aksioni i gjerë policor-prokurorial i njohur në publik si “Botoks”, i cili synon zberthimin e një rrjeti për furnizim, shpërndarje dhe përdorim të paligjshëm të botoksëve dhe fillerëve të falsifikuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas informacioneve të publikuara, aksioni përfshin disa mjekë, pronarë të ordinancave private dhe persona të lidhur me institucione shëndetësore, përfshirë edhe staf mjekësor nga klinika të njohura. Rasti ngre pyetje serioze për integritetin e sistemit shëndetësor, etikën profesionale, funksionimin e mekanizmave inspektues dhe rregullatorë, si dhe shkallën e mbrojtjes së interesit publik kur shëndeti i qytetarëve ekspozohet drejtpërdrejt ndaj rrezikut. Për më tepër, interesi publik preket veçanërisht për shkak të natyrës së produkteve, të cilat mund të shkaktojnë pasoja të rënda shëndetësore, përfshirë dëmtime të përhershme, invaliditet ose humbje të shikimit.

Vlerësimi i integritetit politik

Kategoria: Mbrojtja e interesit publik

Vlerësimi: Vulë e zezë (-10)

Sipas indikatorëve të metodologjisë së Indeksit të Integritetit Politik, rasti përmban disa elemente që tregojnë shkallën më të lartë të cenimit të integritetit: veprimtari të organizuar të paligjshme, keqpërdorim të pozitës profesionale, rrezikim të drejtpërdrejtë të shëndetit të qytetarëve, dobësi institucionale dhe erozion serioz të besimit në sistemin shëndetësor.

Argumentet kryesore:

1. Keqpërdorim i veprimtarisë mjekësore për përfitim privat përmes preparateve të paligjshme

Informacionet e publikuara tregojnë se një pjesë e personave të përfshirë, [përfshirë profesionistë mjekësorë, kanë mundësuar përdorimin dhe shpërndarjen e botoksëve dhe fillerëve të paligjshëm ose të falsifikuar](#). Kjo përbën shkelje serioze të etikës mjekësore dhe keqpërdorim të autoritetit profesional në dobi të interesit privat.

2. Rrezik serioz për shëndetin e qytetarëve

[Përdorimi i preparateve mjekësore të pakontrolluara dhe të paligjshme](#) krijon rrezik për [pasoja të rënda shëndetësore](#). Në këtë kontekst, rasti nuk është vetëm krim ekonomik ose rregullator, por cenim i drejtpërdrejtë i interesit publik përmes [ekspozimit të pacientëve](#) ndaj [substancave potencialisht të rrezikshme](#).

3. Dyshime për veprim të organizuar dhe sistemik të paligjshëm

Numri i personave të përfshirë, lidhjet mes strukturave [private dhe publike](#) shëndetësore, si dhe [përmasat e hetimit](#), tregojnë se nuk bëhet fjalë për një incident të izoluar, por për një [problem më të gjerë sistemik](#) me elemente të mundshme të [veprimit të organizuar të paligjshëm](#).

4. Dobësi në mbikëqyrjen dhe kontrollin institucional

Rasti ngre pyetje serioze për efikasitetin e inspektimeve shëndetësore, kontrolleve doganore, licencimit dhe mbikëqyrjes profesionale. [Funksionimi afatgjatë](#) i praktikave të tilla tregon për dobësi të mundshme strukturore në sistemin e kontrollit.

5. Cenim i besimit në sistemin shëndetësor

Kur profesionistët shëndetësorë dhe institucionet mjekësore lidhen me aktivitete të paligjshme që rrezikojnë drejtpërdrejt shëndetin e pacientëve, besimi i qytetarëve në profesionin mjekësor, institucionet dhe mekanizmat mbrojtës dëmtohet rëndë.

Rekomandim për mbrojtjen e integritetit:

Rasti “Botoks” tregon për një mungesë serioze institucionale në sistemin e kontrollit të preparateve mjekësore dhe ndërhyrjeve estetike. Kombinimi i preparateve të paligjshme, përfshirjes së profesionistëve shëndetësorë dhe mundësisë së pasojave të rënda për shëndetin e pacientëve përbën cenim serioz të interesit publik dhe të besimit në sistemin shëndetësor.

Nevojitet reagim institucional i menjëhershëm dhe i dukshëm, veçanërisht në pjesët e mëposhtme:

- zbardhje e plotë e përgjegjësisë për të gjithë personat dhe institucionet shëndetësore të përfshira;
- heqje e përkohshme ose e përhershme e licencave në rastet e shkeljeve të rënda të konfirmuara;
- publikim i informatave për ordinancat e sanksionuara dhe preparatet e paligjshme, me qëllim mbrojtjen e qytetarëve;
- kontrolle të shtuara dhe të rregullta në fushën e mjekësisë estetike;
- vendosje e një sistemi për gjurmueshmëri dhe verifikim të origjinës së preparateve mjekësore;
- përgjegjësi e qartë institucionale nëse vërtetohen mangësi në mbikëqyrjen inspektuese dhe rregullatore.

II. 5 Rasti – Pjesëtarë të MPB-së në raste të veprimit të paligjshëm dhe mangësi në mbikëqyrjen institucionale



Në fokus të kësaj analize janë disa raste të lidhura me pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët, sipas informacioneve të publikuara, kanë shkelur ligje dhe standarde profesionale që vetë janë të detyruar t'i zbatojnë. Analiza përfshin rastet e zyrtarëve policorë që kanë drejtuar automjete nën ndikimin e alkoolit, me ndalesa aktive për drejtim automjeti ose pa leje përkatëse, si dhe rastin e pilotit në Sektorin për Njësi Ajrore, i cili ka përdorur licencë të falsifikuar.

Edhe pse bëhet fjalë për ngjarje të ndryshme, përsëritja e tyre ngre pyetje serioze për integritetin profesional, kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen institucionale brenda MPB-së.

Kategoria: Korrupsion

Vlerësimi: Skandal (-8)

Sipas metodologjisë së Indeksit të Integritetit Politik, ky rast kualifikohet si **“SKANDAL”** për shkak të përsëritjes së veprimeve serioze të paligjshme, cenimit të drejtpërdrejtë të sigurisë publike, si dhe mangësive institucionale në kontrollin kadrovik dhe të sigurisë. Kur shkeljet kryhen nga persona të ngarkuar me zbatimin e ligjit, pasojat për besimin publik dhe sundimin e ligjit janë veçanërisht të rënda.

Argumentet kryesore

1. Pjesëtarë të MPB-së kanë shkelur ligjet që janë të detyruar t'i zbatojnë

Raste të publikuara ku zyrtarë policorë kanë drejtuar automjete [nën ndikimin e alkoolit](#), me [ndalesa aktive për drejtim](#) ose [pa leje drejtimi](#), përbëjnë cenim serioz të integritetit profesional.

2. Kontroll i pamjaftueshëm kadrovik dhe i sigurisë brenda institucionit

[Rasti me pilotin](#), i cili për një periudhë të gjatë ka kryer detyra me dokumentacion të dyshimtë ose të falsifikuar, ngre pyetje për efikasitetin e mekanizmave të brendshëm të verifikimit dhe mbikëqyrjes. Veçanërisht shqetësues është fakti që bëhet fjalë për një pozitë me shkallë të lartë përgjegjësie dhe rreziku potencial për sigurinë.

3. Cenim i besimit në institucionin përgjegjës për sigurinë publike

MPB-ja ka rol kyç në mbrojtjen e ligjshmërisë dhe sigurisë publike. Prandaj, çdo devijim serioz nga standardet ligjore dhe etike nga ana e pjesëtarëve të saj ka ndikim shumë më të madh në besimin publik sesa te institucionet e tjera.

Rekomandim për mbrojtjen e integritetit

Ky rast tregon nevojën për zbatim të qëndrueshëm të parimit të përgjegjësisë dhe për më shumë transparencë në trajtimin e rasteve kur pjesëtarë të MPB-së shkelin ligjet dhe standardet profesionale. Reagimi i dukshëm institucional është i rëndësishëm jo vetëm për sanksionimin e shkeljeve individuale, por edhe për ruajtjen e integritetit të institucionit dhe të besimit të qytetarëve.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet të:

- sigurojë më shumë transparencë për rezultatin e procedurave disiplinore në rastet që shkaktojnë interes të madh publik;
- sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të standardeve profesionale dhe etike për të gjithë të punësuarit, pavarësisht pozitës ose funksionit të tyre;
- forcojë llogaridhënien publike përmes informimit të rregullt mbi masat e ndërmarra në rastet e cenimit serioz të integritetit profesional.

II. 6 Rasti – Ish-drejtoresha e Spitalit Klinik në Manastir: dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare



Në fokus të kësaj analize janë pretendimet për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e ish-drejtoreshës së Spitalit Klinik në Manastir, në kontekstin e një kallëzimi penal të paraqitur. Analiza bazohet në informacione të publikuara dhe raporte mediatike që tregojnë për parregullsi të mundshme në menaxhimin e mjeteve financiare dhe vendimeve kadrovike në spital, si dhe për reagimin institucional përmes hapjes së procedurës. Rasti ngre pyetje për menaxhimin e institucioneve publike shëndetësore, llogaridhënien e personave drejtues dhe mbrojtjen e mjeteve publike.

Vlerësimi: Skandal (-8)

Kategoria: Korrupsion

Elementi kryesor në këtë rast është ekzistenca e pretendimeve serioze për keqpërdorim të detyrës zyrtare, e shoqëruar me reagim formal institucional, përkatësisht me kallëzim penal të paraqitur. Edhe pse procedura është në vijim dhe nuk ka ende vendim të formës së prerë, shumica e pretendimeve për parregullsi financiare, vendime të dyshimta kadrovike dhe tregues për shmangie të procedurave, sinjalizojnë rrezik të lartë për cenim të integritetit. Shtrirja e pretendimeve, si dhe natyra e tyre, që përfshin menaxhimin e mjeteve publike dhe burimeve njerëzore, tregojnë për mangësi të mundshme sistematike në drejtim. Përveç përgjegjësisë drejtuese, rasti ngre edhe pyetje për integritetin individual të personave për të cilët ka gjetje se kanë qenë objekt i këtyre vendimeve kadrovike. Nëse vërtetohet se avancimet ose benefitet janë dhënë jashtë procedurave të parashikuara, kjo do të përbënte rrezik shtesë për cenimin e integritetit në institucion.

Sipas metodologjisë së Indeksit, një rast i tillë klasifikohet si **“Skandal”**, sepse përfshin dyshime serioze, procedurë institucionale dhe interes të konsiderueshëm publik.

Argumentet kryesore

- **Kallëzim penal i paraqitur**
Institucionet kompetente kanë paraqitur kallëzim penal për dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë ushtrimit të funksionit.
- **Pagesa të paarsyeshme dhe dëm financiar**
Sipas pretendimeve, janë kryer pagesa të paarsyeshme me të cilat është dëmtuar [buxheti i spitalit](#), çka përbën keqpërdorim të drejtpërdrejtë të mjeteve publike.
- **Pagesa pa procedurë të duhur**
Ka indikacione për [pagesa dhe rritje pagash](#) pa respektuar procedurat e përcaktuara.
- **Vendime kadrovike me bazë të dyshimtë**
Ekzistojnë pretendime për [avancime](#) dhe emërimet e personave në pozita pa kualifikimet e duhura ose [pa procedurë transparente](#), gjë që e forcon dyshimin për keqpërdorim të autorizimeve.
- **Shtrirje e gjerë e parregullsive**
Pretendimet mbulojnë disa fusha: financat, burimet njerëzore dhe procedurat administrative, çka tregon për një problem të mundshëm sistematik në drejtim.
- **Reagime të polarizuara në publik**
Ka reagime dhe [demante](#) nga palët e prekura, gjë që thekson edhe më shumë nevojën për përcaktim institucional të fakteve.

Rekomandim për mbrojtjen e integritetit

Rasti i ish-drejtoreshës së Spitalit Klinik në Manastir tregon për dyshime serioze për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe menaxhim të parregullt të mjeteve publike. Edhe pse procedura është në zhvillim, shtrirja dhe natyra e pretendimeve, si dhe kallëzimi penal i paraqitur, krijojnë bazë për integritet të cenuar. Në këtë drejtim rekomandohet:

- të sigurohet procedurë institucionale transparente dhe publike;

- të forcohen mekanizmat e kontrollit financiar në institucionet publike shëndetësore;
- personat drejtues të mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për pagesa dhe punësime që bien ndesh me rregulloret;
- të rritet transparenca në menaxhimin e mjeteve publike në shëndetësi.

III - PËRFUNDIM DHE UDHËZIME PËR FORCIMIN E INTEGRITETIT

Rastet e analizuara në këtë cikël gjashtëmujor nuk përbëjnë vetëm një seri incidentesh të ndara në institucione të ndryshme. Përkundrazi, ato tregojnë një sfidë më të gjerë me të cilën përballlet sistemi institucional; mekanizma jo mjaftueshëm efikasë për parandalim, kontroll dhe llogaridhënie, të cilët duhet të sigurojnë njohjen dhe ndalimin në kohë të rreziqeve ndaj interesit publik.

Edhe pse rastet ndryshojnë për nga natyra e tyre, nga dyshimet për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, përmes konfliktit të interesit dhe mungesës së transparencës, deri te rrezikimi i drejtpërdrejtë i shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve, të gjitha hapin të njëjtën pyetje: a kanë institucionet kapacitet dhe vullnet të mjaftueshëm për t'i zbuluar dhe korrigjuar vetë dobësitë e tyre para se ato të shndërrohen në skandale publike?

Lidhja e përbashkët që i bashkon të gjitha rastet është fakti se reagimi zakonisht vjen pasi problemi tashmë është bërë publik. Në vend që sistemi të veprojë në mënyrë parandaluese, institucionet shpesh reagojnë nën presionin e zbulimeve mediatike, dyshimeve publike, kallëzimeve penale ose veprimeve të organeve të tjera kompetente. Kjo krijon përshtypjen se mekanizmat e integritetit aktivizohen vetëm kur dëmi tashmë është bërë, e jo kur ai mund të parandalohet. Njëkohësisht, ky model tregon edhe kapacitet të kufizuar të institucioneve për t'i identifikuar dhe adresuar vetë rreziqet ndaj integritetit.

Pasojat e kësaj gjendjeje janë më të gjera sesa vetë rastet. Secili gabim i veçantë mund të jetë i kufizuar në një institucion konkret, por përsëritja e tyre në sektorë të ndryshëm krijon perceptimin se sistemi nuk funksionon njësoj për të gjithë. Kur institucionet që duhet ta mbrojnë interesin publik vetë bëhen objekt dyshimesh për integritet të cenuar, besimi i qytetarëve në paanshmërinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien e tyre bie gradualisht.

Historia e shoqërive demokratike tregon se besimi është vlera institucionale më e vështirë për t'u fituar, por edhe më e lehta për t'u humbur. Ai nuk zhduket nga një skandal i vetëm, por nga akumulimi i rasteve që krijojnë ndjesinë se përgjegjësia është selektive dhe kontrolli i pamjaftueshëm. Në të njëjtën kohë,

përvojat e shteteve që i kanë forcuar me sukses institucionet tregojnë se besimi mund të rikthehet kur integriteti bëhet vlerë praktike, e jo vetëm parim deklarativ.

Prandaj, mesazhi më i rëndësishëm i këtij raporti është se forcimi i integritetit politik dhe institucional nuk është vetëm çështje etike apo praktike. Ai është parakusht për rikthimin e besimit në institucionet demokratike. Sa më transparente, më llogaridhënese dhe më të afta të jenë institucionet për t'i njohur dhe sanksionuar vetë dobësitë e tyre, aq më shumë qytetarët do të besojnë se ato ekzistojnë vërtet për t'i mbrojtur të drejtat, interesat dhe sigurinë e tyre. Në këtë kuptim, integriteti nuk është qëllim në vetvete, por ai është themeli mbi të cilin ndërtohet besimi, ndërsa besimi është themeli mbi të cilin ndërtohet një demokraci rezistente dhe funksionale.

Përveç rekomandimeve të përgjithshme, të cilat nënkuptojnë qasje afatgjate dhe reformuese për ndërtimin e sistemeve që forcojnë integritetin dhe kërkojnë burime shtesë dhe përkushtim institucional, rastet e analizuara mundësojnë identifikimin edhe të dobësive konkrete për të cilat janë të mundshme zgjidhje më të shpejta dhe më operative.

Udhëzime për forcimin e integritetit institucional

1. Më shumë përgjegjësi nga bartësit e funksioneve publike

Rastet e analizuara tregojnë se integriteti i institucioneve në masë të madhe varet nga sjellja dhe përgjegjësia e personave që i drejtojnë ato ose që mbajnë autorizime publike. Prandaj, është i nevojshëm forcimi i standardeve të llogaridhënies dhe përgjegjësisë publike të bartësve të funksioneve, veçanërisht në situata kur ekzistojnë indikacione serioze për mangësi ose cenim të interesit publik.

2. Më shumë vëmendje ndaj rreziqeve të konfliktit të interesit dhe konfliktit të roleve

Para zgjedhjes ose emërimit të personave në pozita drejtuese, është e nevojshme të kryhen verifikime më gjithëpërfshirëse për rreziqet e konfliktit të interesit, respektimin e standardeve profesionale dhe etike, si dhe për procedurat e mëparshme disiplinore ose penale. Numri i madh i rasteve që tregojnë shkelje serioze nga persona në pozita të larta ngre pyetjen nëse mekanizmat ekzistues të verifikimit janë mjaftueshëm thelbësorë dhe efikasë.

3. Më shumë transparencë në trajtimin e rasteve me interes publik

Në rastet që hapin pyetje serioze për integritetin e institucioneve ose të bartësve të funksioneve publike, është me rëndësi të veçantë që publiku të informohet për veprimet institucionale dhe për rezultatin e tyre. Transparenca është parakusht i rëndësishëm për besim dhe llogaridhënie.

4. Lidhja e besimit të qytetarëve me politikat institucionale

Institucionet ekzistojnë në shërbim të qytetarëve dhe pikërisht besimi i tyre duhet të jetë një nga treguesit kryesorë të suksesit të politikave institucionale. Për këtë arsye, është e nevojshme të zhvillohen rregullisht hulumtime për besimin e qytetarëve dhe rezultatet e tyre të përdoren si indikator shtesë për vlerësimin e efekteve të masave për integritet, transparencë dhe llogaridhënie.